



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORT

ANALIZA E GJENDJES SË UJIT TË PA-FATURUAR NË KOSOVË

Janar-2020

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
SHKURTESAT	3
1. HYRJE	4
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
3. UJI I FATURUAR, UJI I PA-FATURUAR: PËRKUFIZIMI, TERMINOLOGJIA	6
4. UJI I PA-FATURUAR PËR KOSOVË	7
4.1 UJI I PA-FATURUAR NË NIVEL SEKTORI	7
4.2 UJI I PA-FATURUAR PËR KRU	11
4.3 STRATEGJITË PËR ZVOGËLIMIN E UPF	17
4.4 MODËLI I BALANCIT TË UJIT, RËNDËSIA DHE ZBATIMI	19
4.5 TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR UPF	20
4.6 UPF-TREGUES KYÇ I PERFORMANCËS SË KRU	21
5. NDIKIMI I HUMBJEVE TË UJIT NË EFIÇIENCËN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE DHE TEK KONSUMATORËT	23
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	24
SHTOJCA: Balanci i ujit për KRU-të për periudhën 2018	26

SHKURTESAT

DMA – Zona e Mbyllur Matëse

ILI – Indeksi i rrjedhjes infrastrukturore (InfrastructureLeakageIndex)

ANU-Asociacioni Ndërkombëtar i Ujit (IWA)

WLTF -Task Force për Humbjen e Ujit (IWA)

UPF –Uji i Pa-Faturuar

KRU-Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit

IP - Indikator i Performancës

MBU- Modeli i Balancit të Ujit

NPM-NP- Njësia për Politika dhe Monitorimi të Ndërmarrjeve Publike

BD- Bordi i Drejtorëve

KNMU-Këshilli Ndërmintorror i Ujërave

PMV-Plani i Monitorimit Vjetor

TKP- Treguesit Kyq të Performancës

1. HYRJE

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen ofruesit e shërbimeve në Kosovë, është përqindja e madhe e ujit të pa-faturuar. Pra kjo është një sasi e ujit që prodhohet dhe pompohet në rrjetin e shpërndarjes por nuk faturohet, dhe kështu nuk gjeneron të ardhura për ndërmarrjen. Me fjalë të tjera, uji i pa-faturuar është ndryshimi në mes të ujit të prodhuar dhe ujit të faturuar. Ky ujë humbet si pasojë rrjedhjeve ose shpërthimeve që rrjedhin nga: një presion i lartë në rrjetë, infrastruktura e vjetruar, lidhjet e paligjshme, performanca e dobët e ujëmatësve dhe leximit të pasaktë të tyre, etj. Me gjithë trendët pozitive në disa nga KRU, ujit i pa-faturuar vazhdon të ketë nivele të larta pa përfundim në të shtatë KRU. Për më tepër uji i pa-faturuar vazhdimisht ka qenë pjesë identifikuese e tyre dhe vetëm tani në vitet e fundit ka marrë vëmendjen e shtuar. Humbja e rreth 90 mil.m³, nga totali i ujit të trajtuar çdo vit, vlerësuar në mënyrë konservatore në 30 mil. Euro, nuk është diçka që menaxhmenti i KRU mund ta injoroj. Ulja e këtyre humbjeve të ujit është: thelbësore për përdorimin efikas të burimeve, menaxhimin efikas të shërbimeve, rritjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve dhe shtyrjen e investimeve kapitale për rritjen e kapaciteteve prodhuese. Siç edhe thuhet në qarqet shkencore të industrisë së ujit, kostoja e përmirësimit për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, është shumë më e ulët kur ato ndërmerren përmes investimeve në uljen e ujit të pa-faturuar, sesa përmes investimeve në projekte kapitale për të rritur kapacitetet e furnizimit.

Ofruesit e shërbimeve të ujit janë në përpjekje për të siguruar konsumatorët e tyre, të marrin furnizim të vazhdueshëm dhe cilësor dhe gjatë këtij angazhimi, ata kanë hasur në shumë sfida siç janë: infrastruktura e rrënuar me nivele të larta rrjedhjeje, operacione dhe politika të dobëta të mirëmbajtjes adekuate përfshirë mungesën e mbajtjes së sistemeve efektive të menaxhimit të aseteve, kapacitete të kufizuara në menaxhimin e ujit të pa-faturuar, kufizimet financiare përfshirë mbledhjen e të ardhurave, mjedisi i dobët llogaridhënës, mungesë të stimulimit të performancës si dhe ndikime politike, kulturore dhe sociale. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar edhe në fushën e administrimit të humbjeve dhe kërkesës për ujë. Sidoqoftë UPF është njëri nga shkaqet i cili vazhdon të kufizoj burimet e domosdoshme financiare në dispozicion të Ofruesve të shërbimeve, për të adresuar të gjitha sfidat me të cilat ato po përballen. Më parë menaxhimi i UPF është bazuar më shumë në supozime sesa në shkencë precize, pjesë e problemit ishte mungesa e një qasjeje standarde për përcaktimin dhe identifikimin e komponentëve të UPF. Kjo ka ndryshuar në mënyrë dramatike në shumë vende evropiane dhe më gjerë por edhe tek ne viteve të fundit.

Nisur nga presioni Institucional mbi Ndërmarrjet e ujit në Kosovë për të ulur UPF, dhe për të adresuar këtë situatë, ato kanë hartuar Strategjitë individuale për një periudhë pesë vjeçare (2018-2022). Autoriteti Rregullator i shërbimeve të ujit, gjatë vitit 2018, po ashtu miratoi strukturën dhe terminologjinë standarde sipas metodologjisë së botuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Ujit (IWA) dhe Modelin e Balancit të Ujit, në lidhje me vlerësimin dhe raportimin e UPF. Kjo metodologji jo vetëm që i ndihmon ofruesit e shërbimeve në identifikimin e humbjeve se ku ndodhin, por gjithashtu shpreh sasi të vëllimore të ujit se sa është humbur e shoqëruar me një kosto korensproduese. Themeli i programit të kontrollit të humbjes së ujit është përpilimi i kontrollit të ujit me një rutinë bazë si një praktikë standarde biznesi. Pra tani ofruesit e shërbimeve të ujit, tani kanë një rregull për auditim të ujit në një mënyrë të ngjashme me atë se si një firmë kontabël, ekzaminon në mënyrë rutine financat e një biznesi.

Sido që të jetë ky raport i hartuar nga zyrtarët e ARRU, ka mbërritur në një kohë të rritjes së presionit të publikut dhe palëve të interesit mbi KRU për të adresuar sfidën e reduktimit të UPF, rolin kritik të menaxhimit të ujit të pa-faturuar, elementeve përbërëse dhe masave shoqëruese për adresimin e tij. Këto informacione do të duhej të ju shërbejnë: Ofruesve të shërbimeve të ujit, politikbërësve (Aksionarit të kompanive të ujit, Autoritetit rregullator të shërbimeve të ujit), investitorëve dhe të gjithë atyre të cilët mund të shpresojmë se ndihmojnë në ndryshimin dhe menaxhimin e ujit të pijshëm.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Emëruesi kryesor i përbashkët me të cilën po përballen ofruesit e shërbimeve të ujit në vend është niveli i lartë i humbjeve të ujit në rrjetin shpërndarjes dhe kjo ka bërë, që përmbushja e kërkesave të konsumatorëve për ujë të jetë e vështirë. Ato janë detyruar që të rrisin sasinë enorme të prodhimit të ujit dhe kjo nuk ka sjell të ardhura, përkundrazi i ka rritur kostot dhe e ka bërë më të vështirë mbajtjen e tarifave të ujit në një nivel të arsyeshëm dhe të përballueshëm. Në nivel vendi norma e UPF është rreth 60% dhe pa ndonjë përmirësim të dukshëm për gjatë viteve. Kjo ka treguar një performancë jo të mirë dhe menaxhim të dobët të ndërmarrjeve publike të furnizimit me ujë.

Ndërsa ekzistojnë shumë shpjegime dhe justifikime, shumë nga dështimet janë për shkak të nënvlerësimit të vështirësive teknike dhe kompleksitetit të menaxhimit të UPF. Menaxhmenti ekzekutiv, gjatë kësaj kohe nuk kanë qenë në dijeni të mjaftueshme se sa janë përfitimet dhe kostoja e UPF, së bashku me potencialin për përmirësim, prandaj edhe nuk kanë qenë në gjendje t'i bindin Bordet e Drejtorëve (Aksionarin) e shërbimeve për tu angazhuar në sigurimin e fondeve për aktivitetet e menaxhimit të UPF¹, dhe investimeve të nevojshme në këtë drejtim. Nga ana tjetër mungesa e mbështetjes nga zyrtarët kryesorë ekzekutiv për menaxhimin gjithëpërfshirës e ka bërë të vështirë motivimin e personelit të kyçur drejtpërdrejtë në aktivitete dhe ofrimin e mbështetjes (financimin, trajnimin dhe teknologjinë) për të zvogëluar me sukses dhe në mënyrë të qëndrueshme UPF.

Rreth 60% nga ujë i trajtuar çdo vit vazhdon të humbas. Nga ana tjetër për të përmbushur kërkesën në rritje, disa nga KRU (Prishtina, Gjakova dhe Mitrovica), kanë zhvilluar burime të reja. Më shumë ujë kanë prodhuar dhe distribuuar në rrjetë pa pasur mundësi t'i rrisin shitjet dhe ky cikël ende është duke vazhduar. Sidoqoftë nuk ka ndonjë shembull të suksesshëm dhe gjithëpërfshirës në nivel vendi nga ndonjë ofrues i shërbimeve që zvogëlojnë UPF, në rastin me të mirë është gjendja në KRU 'Gjakova', ku niveli i humbjeve të ujit ka shënuar trend të rënies së lehtë aktualisht norma është 44% dhe është ende larg një nivel të pranueshëm prej 25%.

Për të gjitha KRU, zvogëlimi i UPF ka qenë dashur të jetë opsioni i parë i ndjekur kur është synuar zgjerimi i mbulimit të shërbimeve dhe rritjes së kërkesës për furnizim me ujë të pijshëm. Zgjerimi i rrjetit të ujit, pa adresuar humbjet e ujit ka quar në një cikël jo efikasiteti. Gjithashtu një shkallë e lartë e UPF ishte e lidhur ngushtë me shpenzime të larta të energjisë, pasi uji i transportuar në rrjetë ishte "i ngarkuar" me energji përmes proceseve të shpërndarjes dhe trajtimit, kështu është humbur energjia së bashku me ujin. Prandaj, në çfarëdo variante niveli i lartë i UPF, ka ndikuar në efikasitetin e përgjithshëm dhe qëndrueshmërinë financiare, pasi nuk ka siguruar të ardhura shtesë dhe ka rritur kostot e furnizimit.

Ka pasur dhe vazhdon të ketë projekte në mbështetje të KRU për adresimin e zvogëlimit të UPF, por duhet pranuar se zvogëlimi i UPF, nuk ka mundur të zgjidhet përmes këtyre projekteve. Në këtë drejtim është kërkuar nga KRU të bëjnë ristrukturimin e nevojshëm në aspektin organizativ dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale. Meqenëse adresimi i UPF dhe këto ndryshime kërkojnë edhe kohë. Reduktimi i UPF do të kërkojë përpjekje të mëtutjeshme dhe të vazhdueshme për të ruajtur nivelet e ulëta pasi të jetë bërë përparimi fillestar. Pra gjatë rrugës është e rëndësishme dhe e domosdoshme që ndërmarrjet të zhvillojnë aftësi të brendshme për t'u marrë me këtë çështje thelbësore në vazhdimësi.

¹Startegjia Zhvillimore e Kosovës (2016-2021)

3. UJI I FATURUAR, UJI I PA-FATURUAR: PËRKUFIZIMI, TERMINOLOGJIA

Një parakusht për llogaritjen e treguesve të performancës për humbjet e ujit dhe që ato të jenë të krahasueshme si në nivel vendor dhe ndërkombëtar është përdorimi i një terminologjie të standardizuar. Dukë u nisur nga ky qëllim Asocacioni Ndërkombëtar i Ujërave (IWA) ka zhvilluar dhe rafinuar një gamë gjithëpërfshirëse të treguesve të performancës për shërbimet e furnizimit me ujë. Si pjesë e një iniciative të filluar në fund të viteve 1990 dhe të finalizuar me një Balancë Ndërkombëtare të Ujit. Kosova së fundi ka adoptuar këtë metodologji dhe që nga vit 2018, ka filluar së aplikuar llogaritjen e UPF sipas MBU me gjithë terminologjinë dhe përkufizimet e saj të definuar.

UJI I FATURUAR -KONSUMI I AUTORIZUAR

Paraqet vëllimin e ujit të matur dhe/ose të pa matur i marrë nga konsumatorët e regjistruar, që janë të autorizuar në mënyrë të shprehur ose të qartë për ta bërë këtë nga furnizuesi i ujit të pijshëm për qëllime të përdorimit në amvisëri, biznese dhe institucione, këtu gjithashtu përfshihet edhe uji i pijshëm i eksportuar përtej kufijve operacional të ofruesit të shërbimeve. Konsumi i autorizuar i faturuar, sjellë të ardhura (i njohur edhe si uji i të ardhurave) mund të jetë: Konsumi i matur i faturuar dhe Konsumi i pa matur i faturuar.

UJI I PA- FATURUAR - HUMBJET E UJIT

Është dallimi/ndryshimi në mes ujit që hynë në sistem dhe konsumit të autorizuar.

Uji i Pa faturuar (UPF) përbëhet nga:

(i) Humbjet fizike (reale)

Janë të gjitha humbjet fizike të ujit nga sistemi i gypave nën presion dhe depozitat e ujit në zonën e shërbimit, deri në pikën e përdorimit të konsumatorit. Në sistemet e matura ku është ujëmatësi i konsumatorit dhe në situata ku uji shfrytëzohet në mënyrë të pa matur, kjo është pika e parë e përdorimit brenda pronës. Vëllimi vjetor i humbur në të gjitha llojet e rrjedhjeve, prishjeve dhe tejmbushjeve të depozitave, varet nga frekuencat, ritmet e rrjedhës dhe kohëzgjatja mesatare e rrjedhjeve, prishjeve dhe tejmbushjeve individuale të depozitave.

(ii) Humbjet komerciale (të dukshme)

Përfshijnë të gjitha llojet e pasaktësive që lidhen me: matjen e konsumatorëve, gabimet në trajtimin e të dhënave (leximi i njehsorit, vlerësimet për faturimin paushall), dhe konsumi i paautorizuar (përdorimi i paligjshëm ose vjedhja).

(iii) Konsumi i autorizuar i pa-faturuar (uji pa pagesë)

Konsumi i autorizuar i pa-faturuar (uji pa pagesë), përbëhet nga konsumit i autorizuar i cili është i ligjshëm, por nuk faturohet dhe për këtë arsye nuk prodhon të ardhura. Mund të jetë: Konsumi i pa-faturuar i matur dhe Konsumi i pa-faturuar dhe i pa matur. Në konsum të autorizuar, hynë uji i përdorur për zjarrëfikje, shpërlarja e rrjetit të kanalizimeve, shpenzimet nga hidrantët, krojet publike dhe të objekteve të kultit.

Komponentët e UPF-së, mbulojnë tërë sistemin e furnizimit me ujë nga impianti i trajtimit të ujit e deri te ujëmatësi i konsumatorit, që nënkupton se menaxhimi i UPF-së është përgjegjësi e kompanisë së ujësjellësit. Kjo metodë bazohet në matjen e përgjithshme të ujit që hyn në sistem dhe duke e krahasuar atë me vëllimet e përgjithshme të konsumit nga të gjithë konsumatorët, d.m.th, nga konsumatorët e shtëpiak, komercial-industrial dhe institucionalë.

4. UJI I PA-FATURUAR PËR KOSOVË

Kompanitë përkundër disa angazhimeve vetanake por edhe mbështetjes së kufizuar nga projektet e financuara nga donatorët ndërkombëtar, nuk ishin në gjendje që të zgjidhnin situatën alarmuese të humbjes së ujit. Përkundrazi, UPF ka mbetur në nivel të lartë dhe në disa KRU situata është përkeqësuar siç edhe është paraqitur në raportet vjetore të performancës të publikuara nga ARRU.

4.1 UJI I PA-FATURUAR NË NIVEL SEKTORI


Në vitin 2019 UPF qëndron në nivelin prej 55% nga prodhimi i përgjithshëm i ujit dhe KRU nuk arritën ta zvogëlojnë në mënyrë të dukshme atë për një periudhë të gjatë kohore.

Tab.1: Prodhimi, shitjet dhe e UPF (2013-2018 dhe 2019²)

Të dhënat	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Uji i prodhuar m ³	134,459,244	131,828,167	137,044,281	143,736,575	154,220,031	157,761,608	152,877,087
Uji i shitur m ³	58,081,289	55,850,398	59,743,615	62,073,994	64,794,837	66,235,347	68,063,974
UPF %	57%	58%	56%	57%	58%	58%	55%

Tab.1, dhe grafi. 1, pasqyrojnë statistikën e prodhimit, shitjeve si dhe normën e humbjeve të ujit përgjatë shtatë viteve të fundit. Trendi në rritje të prodhimit të ujit nuk është përcjellë me një trend të domosdoshëm për rritje të shitjeve të ujit. Ka pasur një rritje të vazhdueshme të prodhimit të ujit, duke ju përgjigjur kërkesave për furnizim të qëndrueshëm të popullatës. Në vitin 2019, nga 7 (shtatë) KRU, janë prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët e tyre një total prej rreth 152.87 milion m³ ujë i pijshëm e cila vlerë nëse krahasohet me vitin paraprak ka shënuar rënie. Rritja më e madhe e prodhimit të ujit vitet e fundit ka ndodhur në KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina', marrë parasysh se janë dy kompani të cilat kanë pasur reduktime më të mëdha të furnizimit me ujë. Me rritjen e prodhimit të ujit është rritur edhe vëllimi i ujit të pa-faturuar, dhe në vitin 2019, kjo vlerë është mjaft e lartë, rreth 85 milion m³ është uji i pafaturuar i cili nuk sjellë të ardhura për kompanitë, për më tepër krijon shpenzime, si dhe deficite në furnizim të rregullt të popullatës mirëpo nëse ketë vlerë e krahasojmë me vitin paraprak 2018 kemi zvogëlim të UPF diku rreth 6.7 mil.m³.


² Te dhënat e vitit 2019, janë raportuar nga KRU, por ende nuk janë audituar nga ARRU



Graf. 1: UPF, në nivel sektori (2013 – 2019)


Norma e UPF gjatë kësaj periudhe vlerësues është sjell brenda një intervali të ngushtë nga 55% deri në 58% pra për $\pm 3\%$. Trendi i rritjes së ujit të prodhuar nuk është përcjellë me trendin e njëjtë të ujit të faturuar (si rezultat vlerat sasiore të UPF, janë rritur apo zvogëluar në funksion të saj).

Uji i Pa-faturuar 2018



Graf. 2: Struktura e UPF-së, m³/ditë- 2018

Siç shihet edhe nga Graf.2 nga totali prej 250mij m³/ditë, 2/3janë humbje komerciale, 1/3 humbje fizik, dhe vetëm rreth 5,028 m³, apo 2%, nga totali i UPF, është sasia e ujit të pa-faturuar i autorizuar.




Graf.3: Vlerat sasiore e faturimit dhe UPF në m³,2018

Nga totali prej 157,7 mil.m³ të ujit të prodhuar dhe distribuuar për tek konsumatorët në vitin 2018, vetëm 66.2 mil.m³, është shitja e cila ka mundur të realizohet. Nga të gjitha kompanitë 91.5 mil.m³ është UPF dhe nga kjo rreth 57.7 mil.m³ apo rreth 2/3 janë humbje komerciale përderisa 31.9 mil.m³ apo 1/3 janë humbje fizike. Uji i pa-faturuar i autorizuar (zjarr fikje, objekte te kultit, hidrantet , kroje publike etj.) është rreth 1.8 mil.m³.

Tab.2: Të dhëna statistikore norma dhe vlera (Euro) e UPF, nga Modelet e Balanceve të ujit për KRU-2018

MBU 2018	PR	PZ	PE	MIT	GJA	GJI	FE	Sektori
Prodhimi m ³	54,569,918	17,038,292	25,366,310	28,347,492	14,992,458	8,464,519	8,982,619	157,761,608
Uji i faturuar m ³	21,841,205	7,347,813	9,662,715	11,553,469	8,467,412	4,012,702	3,350,038	66,235,354
Uji i pa-faturuar m ³	32,728,713	9,690,479	15,703,595	16,794,023	6,525,046	4,451,817	5,632,581	91,526,254
Humbjet komerciale m ³	17,643,671	6,351,509	11,844,213	10,085,840	4,668,005	2,930,869	4,246,591	57,770,699
Humbjet fizike m ³	14,688,240	3,140,374	3,416,646	6,545,933	1,311,369	1,506,343	1,311,345	31,920,249
Uji i pa-faturuar i autorizuar m ³	396,802	198,596	442,736	162,250	545,671	14,606	74,645	1,835,306
Humbjet komerciale (%)	54%	66%	75%	60%	72%	66%	75%	63%
Humbjet fizike(%)	45%	32%	22%	39%	20%	34%	23%	35%
Uji i pa-faturuar autorizuar(%)	1%	2%	3%	1%	8%	0%	2%	2%


UPF%	60%	57%	62%	59%	44%	53%	63%	58%
Vlera vjetore(e) e UPF ne raport me tarifat mesatare(€)	11,416,670	3,591,783	4,607,930	5,340,277	2,373,018	1,299,369	1,902,841	30,531,890



Graf. 4: Vlera e Faturimit dhe UPF në Euro, 2018

Rreth 25.5 mil euro është vlera e ujit të faturuar, përderisa 30.5 mil euro janë humbjet financiare nga to pjesa më e madhe janë nga humbjet komerciale 25.3 mil.euro, ndërsa 4.4 mil.euro është vlera e humbjeve fizike dhe vetëm 789 mijë euro janë nga uji i pa- faturuar i autorizuar.

Uji i pa-faturuar shprehur ne % (Euro & m³)-2018



Graf. 5: proporcioni i UPF-së Euro dhe m³ shprehur në (%) -2018


Grafikoni më lartë e tregon vlerën dhe ndikimin e komponentëve të UPF-së, në aspektin financiar në nivel sektori. Në këtë rast humbjet komerciale përbëjnë rreth 63% të vëllimit të UPF-së, përderisa përbëjnë 83% të vlerës së përgjithshme monetare të UPF-së, kurse humbjet fizike përbëjnë 35% nga vëllimi total i UPF-së ndërsa përbën vetëm 14% të vlerës së përgjithshme monetare të UPF-së. Kjo qartazi tregon pse llogaritja e bilancit të ujit është instrument mjaft i rëndësishëm për informimin dhe vendimmarrjen strategjike në lidhje me UPF-së. Prandaj, çdo ofrues i shërbimeve, duhet të përgatitet për një vlerësim të shkurtër të kostos dhe përfitimit nga aktivitetet e zbatimit të strategjive të UPF, të bërë në bazë të një modeli të besueshëm të ujit.

Ulja e humbjeve komerciale është pothuajse gjithmonë me kosto efektive dhe ofron kthim të shpejtë dhe aktivitetet janë teknikisht të lehta për t'u realizuar. Nga ana tjetër, ulja e humbjeve fizike përmes kontrollit të rrjedhjeve mund të jetë e kushtueshme, kërkon njohuri teknike të rëndësishme dhe duhet të kryhet gjerësisht për të sjellë rezultate. Është e qartë se investimi i fondeve dhe resurseve në reduktimin e humbjeve komerciale do të tregojë një përmirësim më të madh në bilancin financiar të kompanisë sesa përpjekja për reduktimin e humbjeve fizike. Sido që të jetë kompanitë e ujit duhet të kërkojnë të arrijnë deri tek një ekuilibër ekonomik midis kostove të kontrollit të rrjedhjeve dhe përfitimeve që rrjedhin nga reduktimi i humbjeve të ujit (niveli ekonomik i humbjeve).

4.2 UJI I PA-FATURUAR PËR KRU

KRU-Prishtina

Nivel shumë i lartë i UPF është duke e përcjellë në vazhdimësi KRU'Prishtina', shqetësues është fakti se trendi është në rritje. Nga viti 2013 në 2018, përqindja e UPF ka shënuar rritje për 10% ndërsa në vitin 2019 siç shihet edhe nga grafikoni i mëposhtëm kemi një trend pozitiv në rënie në nivelin 56%. Deri në vitin 2017, kjo kompani kishte aplikuar reduktime të ashpra të furnizimit me ujë. Në vitin 2017, nga kjo kompani u rritën kapacitetet prodhuese edhe për 700l/s, me këtë është përmirësuar furnizimi i rregullt, mirëpo vlera e humbjeve të ujit ka shënuar rritje, përderisa shitjet kanë mbetur konstante me një trend të lehtë të ngritjes gjatë vitit 2019. Nga 54.6 mil.m³, ujë të prodhuar dhe distribuuar, 32.7mil.m³ është ujë i humbur në vitin 2018, pjesa më e madhe rreth 54% janë humbje komerciale dhe 45% janë humbje fizike.




Graf. 6: UPF 2013-2019 KRU "Prishtina"

KRU 'Prishtina', duhet ti adresojë në mënyrë me proaktive humbjet e mëdha të ujit (32.7 mil.m³), duke u angazhuar në mënyrë paralele në të dyja komponentët e humbjeve. Të vendosen dhe verifikohen/kalibrohen ujëmatësit e prodhimit të ujit dhe ujëmatësit e konsumatorëve, duhet përmirësuar saktësinë e të dhënave (përmirësimi i sistemit të raportimit dhe mbajtjes së të dhënave, eliminimi i vlerësimeve të prodhimit dhe konsumit). Të vazhdohet me monitorimin dhe menaxhimin e sistemit të rrjetit duke i zgjeruar zonat e mbyllura matëse (DMA) si dhe të vendosë dhe zbaton një plan efektiv të menaxhimit të asetëve në përgjithësi dhe gypave në veçanti.

KRU-Hidroregjioni Jugor

Në KRU 'Hidroregjioni Jugor', siç mund të vërehet edhe nga grafi nr.7 i UPF ka shënuar trend në rënie shumë të vogël për gjatë kësaj periudhe vlerësuese (2013-2019) dhe kjo është kryesisht nga shkak i zvogëlimit të prodhimit ndër vite dhe gjendjes pothuajse të njëjtë të shitjes së ujit. Gjatë vitit 2018 nga totali prej 57% të vlerës së UPF, 66% janë humbjet komerciale, 32% humbje fizike dhe vetëm 2%, vlerësohet uji i pa-faturuar i autorizuar.




Graf. 7: UPF 2013-2019 KRU 'Hidroregjioni Jugor'

KRU "Hidroregjioni Jugor", duhet fillimisht të përqendrohet në ndërmarrjen e masave më të shpejta në drejtim të reduktimit të humbjeve komerciale, si: vendosjen e njehsorëve për të gjithë konsumatorët dhe faturimin e tyre ta bëjë përmes ujëmatësve funksional dhe të verifikuar në aspektin e saktësisë, të siguroj matje të plotë dhe të saktë të prodhimit të ujit të bëjë kontrollë sistematike me qëllim të identifikimit dhe eliminimit të kycjeve ilegale, keqpërdorimit të ujit të pijshëm. Po ashtu të ndërmarrë aktivitetet në aspektin e reduktimit të humbjeve fizike si: identifikimi dhe riparimi i rrjedhjeve në kohë sa më të shpejtë si dhe zhvillimi i programeve të menaxhimit të humbjeve të ujit sipas praktikave të mira dhe përmes DMA-ve.

KRU-Hidrodrini

Në KRU "Hidrodrini", është shënuar një zvogëlim i dukshëm i UPF, aktualisht niveli prej 60% gjatë vitit 2019 prapë është shumë e lartë. Kjo kryesisht ka ardhë për shkakun e zvogëlimit të prodhimit për rreth 3.5 mil.m³ në vitin 2019 në raport me vitin 2013, poashtu trend pozitiv është shënuar në shitjet e ujit, ndonëse ato janë shumë graduale. Gjatë vitit 2018 nga totali prej 62% të normes së UPF, ¼ e tyre janë humbje fizik, ¾ e tyre janë humbje komerciale dhe një normë prej 3% konsiderohet të jetë uji i pa-faturuar i autorizuar.




Graf. 8: UPF 2013-2019 KRU 'Hidrodrini'

Prioriteti i masave që duhet marrë nga kjo kompani duhet të jenë me tepër të orientuara në identifikimin dhe zvogëlimin e humbjeve komerciale, në këtë drejtim nuk ka dyshim se përmirësimi i saktësisë së të dhënave të prodhimit të ujit dhe ujit të konsumuar do të jetë i rëndësishëm, prandaj në këtë drejtim KRU "Hidrodrini", duhet të siguroj saktësinë e ujëmatësve përmes verifikimit dhe kalibrimit të rregull të tyre, identifikojë kycjet ilegale. Kompania po ashtu duhet të vendos dhe zhvilloj sistemin e menaxhimit të UPF përmes DMA dhe programit të menaxhimit të aseteve me prioritet rrejtin shpërndarës.

KRU-Mitrovica

KRU "Mitrovica", po përballet me shumë sfida të rëndësishme, duke përfshirë edhe një normë të lartë të UPF. Humbjet e ujit në këtë kompani, në vazhdimësi janë rritur deri në vitin 2017, ndërsa në vitet 2018 dhe 2019 kanë filluar të shënojnë një trend në rënie. Në këtë kompani viteve të fundit janë shtuar dukshëm kapacitetet prodhuese të ujit, furnizimi është përmirësuar, por kjo nuk është përcjellë me të njëjtin ritëm të shitjeve. Sipas të dhënave të nxjerra nga Modeli i Balancit të Ujit, Humbjet komerciale janë gati sa dyfishi i humbjeve fizike. Krahas shpenzimeve tjera edhe humbjet e të ardhurave nga UPF, ndikuan në vazhdimësi në qëndrueshmërinë financiare të kësaj kompanie.

Padyshim se në këtë nivel të lartë të humbjeve ndikon edhe fakti se rreth 30% e konsumatorëve të kësaj kompanie nuk kanë ujëmatës dhe faturimi i tyre bëhet në mënyrë të vlerësuar.




Graf. 9: UPF 2013-2019 KRU 'Mitrovica'

Meqenëse një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve faturohen sipas vlerësimeve (paushall), pajisja dhe programi i matjes së ujit të konsumuar, duhet të jetë një përparësi për KRU "Mitrovica". Ekipi i kontroleve për lidhjet ilegale duhet të forcohet dhe lidhjet e paligjshme të adresohen. Vendosija e një programi të verifikimit dhe kalibrimit, krahas leximit efektiv të ujëmatësve do të sjellë rezultate të menjëhershme në reduktimin e UPF. Kompania po ashtu duhet të miratojë dhe zbatojë aplikacionin e GIS-it, të themelojë DMA-të dhe të zbatoj modelin hidraulik të menaxhimit të presioneve në rrjetin distribuiv.

KRU-Gjakova

KRU "Gjakova", ka shënuar trend të lehtë pozitiv në zvogëlimin e ujit të pa-faturuar përgjatë kësaj periudhe (2013-2019), përmirësimi është për 8%, kjo është përcjellur me një rritje të lehtë të vlerës së faturimit, dhe menaxhim më të mirë të sasisë së ujit të prodhuar. Niveli i normës së UPF prej 44% në vitin 2018, është prej vlerave më të ulëta nga të gjitha kompanitë e tjera. Gjatë vitit 2018 sipas të dhënave të nxjerra nga bilanci i ujit UPF kap vlerën prej 44% ku pjesa më e madhe e humbjeve apo 72% janë të aspektit komercial. Sa i përket ujit të pa-faturuar të autorizuar është raportuar një përqindje e lartë e pjesëmarrjes së humbjeve në këtë kategori prej 8% nga ana e kësaj kompanie.




Graf. 10: UPF 2013-2019 KRU 'Gjakova'

Në KRU "Gjakova", shumica e konsumatorëve (98%), janë me konsum të matur, po ashtu janë të instaluar e ujëmatësit e prodhimit në të gjitha burimet. Prioritet duhet të jetë zhvillimi i programit të mirëmbajtjes dhe verifikimit të ujëmatësve të konsumatorëve duke konsideruar se kjo kompani tani më e ka të licencuar edhe laboratorin për verifikimin-kalibrimin e ujëmatësve. Një përparësi që duhet konsideruar po ashtu nga kompania i domosdoshëm për adresimin efektiv të kontrollimit dhe zvogëlimit të humbjeve fizike dhe komerciale është krijimi i DMA-ve, krahas një fushate efektive për identifikimin e përdoruesve të paligjshëm të ujit.

KRU-Bifurkacioni

KRU "Bifurkacioni", ka pasur fillimisht një përmirësim në zvogëlimin e UPF në vitin 2014, atëherë kur edhe shitjet e ujit treguan një trend pozitiv, me pas ato erdhën duke u rritur për të arritur në nivelin 65% për vitin 2019. Meqenëse kjo kompani nuk ka të vendosur ujëmatës në të gjitha burimet kjo rritje e UPF me tepër mund të jetë për shkak të lëvizjeve në vlerësimin e prodhimit të ujit. Edhe te kjo kompani të dhënat e nxjerrra nga modeli i balancit të ujit tregojnë se humbjet komerciale janë dukshëm më të mëdha në raport me humbjet fizike, apo $\frac{3}{4}$ janë humbje komerciale në raport me $\frac{1}{4}$ humbje fizike dhe 2% ujë i pa-faturuar i autorizuar. Po ashtu edhe humbjet fizike janë të larta dhe kryesisht të diktuar nga performanca e dobët e rjetit të ujësjellësit edhe pse ka pasur një trend pozitiv (zvogëlimi i numrit të defekteve) nga viti i kaluar.




Graf. 11, UPF 2013-2019 KRU 'Bifurkacioni'

Edhe pse në KRU "Bifurkacioni, 96% e konsumatorëve janë me ujëmatës, kompania duhet të vazhdojë edhe më tej që të gjithë konsumatorët e shërbyer prej saj, ti pajisë me ujëmatës. Faturimi sipas ujëmatësve është esenciale, siç do të ishte edhe instalimi i ujëmatësve të saktë në të gjitha pikat e prodhimit dhe trajtimit të ujit. Për menaxhimin dhe reduktimin e humbjeve të ujit, esenciale po ashtu në këtë drejtim do të ishte që ujëmatësit e konsumit por edhe të prodhimit të ujit të mirëmbahen dhe zëvendësohen sipas një programi zbatues, me ç'rast të gjithë ujëmatësit do të nënshtrohen verifikimit dhe kalibrimin për të siguruar saktësi të matjes. Kompania duhet të vendos dhe zbatoj praktiken e monitorimit dhe menaxhimit të humbjeve të ujit në mënyrë efektive përmes DMA-ve.

KRU-Hidromorava

Uji i pa faturuar në KRU "Hidromorava", ka pasur osicilime vit pas viti, kryesisht i ndikuar nga sasia e ujit të prodhuar dhe me pak nga ndikimi i shitjeve të cilat kanë shënuar një rritje të lehtë viteve të fundit. Në vitin 2019, norma e UPF ishte në nivelin 51%. Ndërsa sa i përket të dhënave të kalkuluara nga modeli i balancit të ujit për vitin 2018 humbjet komerciale janë sa dyfishi i humbjeve fizike. Pa përjashtuar mundësinë e konsumit të paligjshëm në humbjet komerciale padyshim ka një ndikim edhe fakti se rreth 8% e konsumatorëve ende faturohen në mënyrë të vlerësuar. Edhe rrjeti i menaxhuar nga KRU 'Hidromorava', ka treguar një performancë të dobët, ndonëse ka trend të përmirësimit.



Graf. 12, UPF 2013-2019 KRU 'Hidromorava'

Duke filluar nga viti 2018 e në vazhdimësi edhe gjatë gjithë vitit 2019, kompania po përballlet me mungesën e resurseve ujore për shkak të thatësisë, konsumatorët i janë nënshtruar reduktimeve të furnizimit me ujë. Prandaj humbjet e ujit në këtë kompani kanë edhe një efekt shumë negativ, jo vetëm në qëndrueshmërinë operative por edhe në aspektet e tjera, të shërbimit ndaj konsumatorëve. Prioriteti dhe fokusi duhet të jetë tek adresimi i humbjeve komerciale siç është kalibrimi i ujëmatësve të konsumit por edhe i ujëmatësve të burimeve-prodhimit të ujit. Duhet forcuar dhe përkrahur ekipet për identifikimin e lidhjeve ilegale dhe të gjitha përdoruesit e paligjshëm të adresohen në sistemin e drejtësisë. Pa lënë anash duhet adresuar edhe humbjet fizike, duke zbatuar dhe siguruar funksionimin e saktë të DMA-ve, me të gjitha aspektet funksionale (menaxhimi i presionit, etj.), si dhe krijimin e një ekipi të zbulimit dhe riparimit të rrjedhjeve. Kompania përfundimisht duhet të dizajnon dhe zbaton një program efektiv për menaxhimin e aseteve me specifik në rrjetin e ujësjellësit.

4.3 STRATEGJITË PËR ZVOGËLIMIN E UPF

Të gjitha kompanitë i kanë hartuar planet strategjike për zvogëlimin e UPF për një periudhë pesëvjeçare (2018-2022), krahas saj është filluar edhe me zbatimin e moduleve të balancit të ujit. Me këto është arritur të kuptohen çështjet thelbësore: sa ujë është duke humbur, nga po humbet dhe pse po humbet si dhe është hartuar plani i veprimit për arritjen e performancës së qëndrueshme në reduktimin e UPF. Strategjitë në vete përmbajnë edhe objektivat vjetore të zvogëlimit të UPF, ato janë sfiduese por njëkohësisht, reale për tu arritur. Në parim është marrë si qëndrim adoptimi i zvogëlimit të humbjeve të ujit me një normë prej 2%, në baza vjetore filluar nga niveli i gjendjes aktuale nga secila, për të arritur në një përmirësim prej 10%, me përfundimin e strategjive. Por nevojitet angazhimi shtuar i menaxhmentit, personelit të kyçur në aktivitete si dhe mbështetje financiare sipas prioriteteve në ndërmarrjen e veprimeve. Monitorimi i zbatimit të strategjive si dhe vlerësimi i progresit është duke u bërë baza të rregullta tremujore në kuadër të grupit ndërinstitucional dhe KRU. Për tu arritur progresi, kompanitë duhet të kenë qasje sistematike dhe të njëkohshëm në adresimin e të gjitha komponentëve të humbjeve të ujit:

Esenciale është Kontrollimi i humbjeve fizike të bëhet sipas elementeve-prioriteteve kryesore:

Kontrolli aktiv i rrjedhjeve, duke e monitoruar, sistemin e rrjetit të gypave në baza të rregullta për të identifikuar shfaqjen e rrjedhjeve të reja më herët në mënyrë që ato të zbulohen dhe riparohen sa më shpejt që të jetë e mundur,

Administrimi i gypave dhe i asetëve, duke menaxhuar dhe rehabilituar rrjetin në mënyrë ekonomike për të zvogëluar nevojën për mirëmbajtje korrektuese,

Shpejtësia dhe cilësia e riparimeve, riparimi i rrjedhjeve në kohën e duhur dhe efikase, përfshirë organizimin e punës dhe mbajtjen e stoqeve të materialeve të riparimit,

Menaxhimi i presionit, rregullimi i presionit të rrjetit përmes përdorimit të arsyeshëm të presionit- zvogëlimi i valvuleve (shpesh një mundësi e nënvlerësuar për uljen e rrjedhjeve).

Veprimet për zvogëlimin e humbjeve komerciale nuk varen shumë nga rrethanat lokale, kryesisht janë të përgjithësuara në të gjitha KRU, përfshirë:

Përmirësimi i saktësisë së njehsorit të konsumatorit, duke siguruar që ujëmatësit e konsumatorëve të jenë në gjendje të duhur të punës,

Përmirësimi i leximit dhe faturimit të njehsorëve, duke eliminuar gabimet në zinxhirin e leximit dhe faturimit nga shkaku i teknologjisë së dobët, apo leximeve manuale, gabimeve në trajtimin e të dhënave në zyrë, por edhe për eliminimin e ndonjë praktike të mundshme mashtruese nga ana e stafit të shërbimeve,

Zbulimi i lidhjeve ilegale dhe keqpërdorimi i ujit, duke hulumtuar dhe identifikuar lidhjet ilegale, sidomos në zonat rurale ku ka mundësi të keqpërdorimit të ujit për ujitje të tokave-kopshteve, apo edhe kontrollë në zonat ku ka ndërtime të shprehura dhe tek bizneset e mëdha etj.

Një pikë e rëndësishme për tu përmendur dhe një parakusht që ofruesit e shërbimeve të përmirësojnë performancën e tyre është edhe sigurimi i stimujve për menaxhmentin dhe stafin e ujësjellësit për të arritur dhe mirëmbajtur zvogëlimin e UPF. Kjo duhet të jetë proporcionale me benefitet nga rritja e efikasitetit në zvogëlimin e UPF.

4.4 MODELI I BALANCIT TË UJIT, RËNDËSIA DHE ZBATIMI

Asociacioni ndërkombëtar i ujit (ANU-IWA) ka zhvilluar një metodë për llogaritjen e balancit të ujit, si një nga metodat më të mira me një përdorim të gjerë ndërkombëtar në industrinë e ujit dhe i cili është hapi i parë në trajtimin praktik të humbjes së ujit. Tab.3, më poshtë ilustron se si format e ndryshme të humbjes së ujit mund të kategorizohen. Për me tepër, metoda përdoret edhe për të përcaktuar se ku duhet të përqendrohen përpjekjet për të arritur ndikimin më të madh. Pra logjika është se ndarja e sasisë së ujit që humbet (UPF), në pjesë më të vogla, jepet mundësia që të punohet në një mënyrë më të strukturuar dhe efektive për zvogëlimin e saj.

Tab. 3: – Balanci i ujit i ANU-së

Vëllimi i ujit që hyn në sistem	Konsumi i autorizuar	Konsumi i autorizuar i faturuar	Konsumi i faturuar i matur (përfshirë eksportet e ujit)	Uji i faturuar
			Konsumi i faturuar i pa matur	
		Konsumi i autorizuar i pafaturuar (uji pa pagesë)	Konsumi i pafaturuar i matur	Uji i pafaturuar (UPF)
			Konsumi i pafaturuar i pa matur	
	Humbjet e ujit	Humbjet komerciale	Konsumi i paautorizuar	
			Pasaktësitë në matje	
		Humbjet fizike	Rrjedhjet në gypat kryesor të bartjes dhe shpërndarjes	
			Rrjedhjet dhe derdhjet në rezervuarë e sistemit të Ujësjellësit	
			Rrjedhjet në kyçjet e shërbimit deri në ujëmatësin e instaluar të konsumatorit	

Viti 2018, ka qenë viti i parë që KRU, sipas kërkesave të ARRU kanë zbatuar dhe raportuar UPF sipas metodologjisë së Balancit të ujit. ARRU, ka ndihmuar të gjitha KRU për përditësimin me të dhëna të Balanceve, gjatë kësaj analize, ne jemi shërbyer edhe me MBU të cilat KRU i kanë përcjellë në versionin final. Duhet potencuar se komponentët e balancit të ujit duhet të maten, vlerësohen ose llogariten duke përdorur një numër teknikash. Në mënyrë ideale të gjithë këta përbërës të rëndësishëm do të duhej të mateshin. Sa i përket të dhënave për prodhimin e ujit dhe faturimit, shifrat kanë një shkallë të caktuar të saktësisë meqë një pjesë e konsiderueshme në mungesë të ujëmatësit vlerësohen. Është dashur të bëhen vlerësime të përafërta sa i përket të dhënave rreth konsumit të paautorizuar (kyçjeve ilegale, lidhjeve jashtë ujëmatësve bypass, etj) dhe gabimeve në leximin e ujëmatësve etj. Së këndejmi duke marr parasysh se e dhëna kryesore, siç është 'vëllimi hyrës në sistem', nuk është tërësisht i saktë, kështu që

përcaktimi i balancave të ujit në këtë rast, që në fillim ka një shkallë të pa-saktësisë. Megjithatë, kemi vlerësuar se ia vlen të përpiqemi për të zbatuar një balancë uji, edhe pse një pjesë e elementeve kryesore të tij bazohen në vlerësime. Me shpresën se ato në vazhdimësi pas ndërmarrjeve të veprimeve konkrete nga KRU, do të vijnë duke e përmirësuar saktësinë. Në rastin konkret MBU në 2018, duke përdorur vlerësimet dhe të dhënat e tjera të matura, softueri e ka llogarit vëllimin e UPF dhe përbërësit e tij të ndryshëm, së bashku me margjinën e gabimeve. Margjina e gabimeve në vlerësimin e UPF përmes modulit të balancit të ujit për vitin 2018, mesatarisht sillet nga më e madhe ($\pm 30\%$) në KRU ‘Bifurkacion’, KRU Hidrodri (±16.2%), KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, (±13.5%), KRU Prishtina’ ±5.5% deri tek margjina e gabimit me e vogël në KRU (Gjakova, Mitrovica dhe Hidromorava) me (±0.0%).

Që ky model të jetë sa më i vlefshëm, të dhënat që sistemohen duhet që ma kalimin e kohës të jenë sa më të klasifikuara apo të verifikuara sa i përket besueshmërisë së tyre.

4.5 TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR UPF

Për momentin, treguesit e performancës që aplikohen për shërbimet e ujësjellësve në Kosovë përfshijnë këta tregues të infrastrukturës së shërbimeve:

- i. Ujin e pa-faturuar (absolut dhe relativ),
- ii. Plasjet (shpeshtësia, absolute dhe relative).

Tabela 4: Treguesit e performancës në Kosovë për ujin e pa-faturuar të vlerësuara nga ARRU

Referenca e ARRU	Treguesi i performancës	Njësia	Përshkrimi
W.1.B.01	Uji i pa-faturuar (gjithsejtë)	m ³ në ditë	Vëllimi mesatar i UPF-së (dallimet ndërmjet ujit të prodhuar dhe atij të shitur) në ditë gjatë periudhës raportuese
W.1.B.02	Uji i pa-faturuar (sipas lidhjes)	Litër për kon. në ditë	Vëllimi mesatar i UPF-së pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të lidhjeve në zonën e shërbimit
W.1.B.03	Uji i pa-faturuar (sipas lidhjes) – e modifikuar	Litra për kon. në ditë	Vëllimi mesatar i UPF-së pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të lidhjeve në zonën e shërbimit të përshtatur për furnizim të kufizuar
W.1.B.04	Uji i pa-faturuar (lidhur me prodhimin)	% e prodhimit	Vëllimi mesatar i UPF-së pjesëtuar me vëllimin e prodhimit
W.1.B.05	Shpeshtësia e plasjeve të rrjetit të gypave	Plasjet sipas muajit	Numri mesatar i plasjeve të gypave në muaj
W.1.B.06	Plasjet e rrjetit të gypave për 100 km të gypave	Nr / 100 km	Numri i përgjithshëm i plasjeve të gypave në vit për 100 km të gypit (duke përjashtuar kycjet e shërbimit)

Deri në fillim të viteve 1990, nuk kishte metoda të besueshme dhe të standardizuara për llogaritjen e humbjeve të ujit. Si pjesë e një iniciative të filluar në fund të viteve 1990, ANU krijoi një Task Force për Humbjen e Ujit (WLTF) për të ekzaminuar praktikat më të mira ndërkombëtare dhe për të zhvilluar tregues të performancës në lidhje me humbjen e ujit. Për rrjedhojë, ANU zhvilloi konceptet, mjetet dhe strategjitë më të përparura të menaxhimit të humbjes së ujit, dhe vendosi në dispozicion të sektorit të shërbimeve të ujit “Modelin e Balancit Ndërkombëtare të Ujit”, me përcaktime të qarta dhe me një terminologji të standardizuar,

Ndoshta më e rëndësishmja, është se ANU ka zhvilluar dhe rafinuar një gamë gjithëpërfshirëse të treguesve të performancës për shërbimet e furnizimit me ujë. Tani UPF ka një përkufizim të saktë dhe të thjeshtë, pra paraqet ndryshimi midis vëllimit të ujit të vendosur në një sistem shpërndarjeje të ujit dhe vëllimit që u faturohet konsumatorëve. UPF përfshin tre përbërës kryesor si më poshtë:

Humbjet komerciale (të dukshme), Përbajnë të gjitha llojet e pasaktësive që lidhen me: matjen e konsumatorëve, gabimet në trajtimin e të dhënave (leximi i njehsorit, vlerësimet për faturimin paushall), dhe konsumi i paautorizuar (përdorimi i paligjshëm ose vjedhja),

Humbjet fizike (ose reale), përbajnë rrjedhje nga të gjitha pjesët e sistemit (gypat) dhe tej mbushjet në rezervuarët e ndërmarrjes,

Konsumi i autorizuar i pafaturuar, përbëhet nga konsumi i autorizuar i cili është i ligjshëm, por nuk faturohet, mund të jetë: Konsumi i pa-faturuar i matur dhe Konsumi i pa-faturuar dhe i pa matur. Në konsum të autorizuar, hynë uji i përdorur për zjarrëfikje, shpërlarje e rrjetit të kanalizimeve, shpenzimet nga hidrantët, krojet publike dhe të objekte të kultit,

Indeksi i rrjedhjes së Infrastrukturës (ILI): Ky është një tregues i pranuar ndërkombëtarisht i humbjeve fizike të zhvilluara nga ANU, ajo që merr parasysh mënyrën e menaxhimit të rrjetit. është raporti i vëllimit aktual vjetor të humbjeve fizike ndaj humbjeve fizike minimale të arritshme vjetore. ILI llogaritet përmes analizës së balancit të ujit dhe mund të përdoret si një TKP i synuar për menaxhimin e UPF.

4.6 UPF-TREGUES KYÇ I PERFORMANCËS SË KRU

Një nivel i lartë i humbjeve të ujit është një nga sfidat kryesore me të cilat përballen shërbimet e ujit në Kosovë ARRU ka zhvilluar Planin e Monitorimit Vjetor, ka përcaktuar metodologjinë, kriteret si dhe ka zhvilluar një skemë të Treguesve Kyç të Performances. UPF është një tregues kryesor i performancës operative dhe financiare për KRU-të ku vlerësimi dhe rangimi i tyre behët në bazë të rezultateve të regjistruara në përbushjen e objektivave referente.

Tab.5 Struktura aktuale e matjes së performancës (TKP dhe pesha e tyre)

Grupi	Njësia matëse e performancës	Koeficienti i nën-grupit		Koeficienti i Grupit	
Ujë	Cilësia e ujit të pijshëm	25%	100%	45%	100%
	Presioni	5%			
	Disponueshmëria	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime	20%			
	Efiçienca e kostos	10%			
	Uji i Pa Faturuar	20%			

Ujëra të ndotura	Cilësia e shkarkimeve	20%	100%	35%	
	Besueshmëria	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime	50%			
	Efiçienca e kostos	10%			
	Pikët (besueshmëria) e përcaktuara prej Auditimit			5%	
	Profitabiliteti			5%	
	Efiçienca komerciale			10%	

Një objektivë afatgjate në PMV është që $UPF \leq 25\%$ dhe në kuadër të ristrukturimit të skemës së TKP është propozuar që të rritet pesha e UPF nga 20% në 25% në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm.

5. NDIKIMI I HUMBJEVE TË UJIT NË EFIÇIENCËN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE DHE TEK KONSUMATORËT

Është e logjikshme se asnjë biznes nuk mund të mbijetojë për një kohë të gjatë nëse humbë një pjesë të konsiderueshme nga prodhimi i tij. Por kjo pikërisht është ajo që po ndodh me ofruesit e shërbimeve të ujit në vend. Nivele të larta të UPF, kanë çuar në nivele të ulëta të efikasitetit. Me humbjen e ujit të trajtuar janë humbur edhe kostot e mbledhjes së ujit, trajtimit dhe shpërndarjes, janë ulur të hyrat nga shitjet e ujit dhe janë zbatuar programet të konsiderueshme të shpenzimeve kapitale për të përmbushur kërkesën gjithnjë e në rritje për ujë. Rrjedhimisht si pasojë, një nivel i lartë i UPF, ka ndikim serioz në qëndrueshmërinë financiare mëqenëse humbin fitime (të ardhura) të konsiderueshme si dhe shkaktojnë shpenzime më të larta operationale për ndërmarrjen, siç është energjia e përdorur për të trajtuar dhe pompuar ujin, kemikale dhe shpenzime të tjera për prodhimin dhe distribuimin e tij. Për më tepër, rrjedhjet kanë kërkuar riparime të shtrenjta të infrastrukturës si dhe një nevojë për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese.

Vlerësimet tona janë se ofruesit e shërbimeve të ujit në vend, humbin rreth 90 mil m³ apo rreth 60%, nga prodhimi i tërësishëm për çdo vit. Nuk është realiste të pritet që Ofruesit e shërbimeve të ujit ti eliminojnë të gjitha humbjet komerciale dhe fizike. Por synimi i tyre në një përrudhë afat shkurte duhet të jetë që nivelet e larta të UPF të përgjysmohen. Dhe nëse vetëm gjysma e saj zvogëlohet, do të sigurohet një sasi prej 45 mil.m³ e mjaftueshme për sigurimin e ujit të pastër për një popullatë shtesë prej 400 mijë njerëz, që kanë nevojë për të. Zvogëlimi i UPF, do të kishte jo vetëm ndikim të dukshëm pozitiv në performancën e ofruesve të shërbimeve, por edhe në rritjen e kualitetit të shërbimeve të ofruara si dhe në rritjen e mbulueshmërisë me sistem të furnizimit me ujë të pijshëm.

Qëllimi kryesor i ofruesve të shërbimeve të ujit është plotësimi i kërkesës së konsumatorëve. Një nivel i lartë i UPF ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e tyre për të përmbushur këtë objektiv dhe për këtë arsye ka një ndikim negativ tek konsumatorët duke shkaktuar mungesë të standardeve të shërbimit. Humbjet e larta fizike për një kohë të gjatë kanë ndikuar në furnizimin e rregullt me ujë, si pasojë konsumatorët i janë nënshtruar reduktimeve të furnizimit me ujë. Kjo edhe ka ndodhur po thuajse në të gjitha zonat e shërbimit të KRU. Furnizimi me ndërprerje ka shkaktuar edhe ulje të cilësisë së ujit, pasi ujërat nëntokësor të kontaminuara, apo edhe kanalizimet, kanë hyrë në gypat gjatë ndërprerjeve të furnizimit dhe gjatë periudhave me presione të ulëta të rrjedhjes. Humbjet e ujit gjithashtu kanë rritur normat e rrjedhës në rrjetin e gypave, të cilat shkaktuan humbje të presionit të nevojshëm që kanë prekur konsumatorët dhe shpesh ka çuar në ndërprerje të furnizimit gjatë orëve të pikut të kërkesës. Të gjitha këto kanë lënë konsumatorët e pa kënaqur me shërbimin e ofruar me pasoja edhe në gatishmërinë e një pjesë të konsumatorëve për të paguar faturat e tyre. Një aspekt i ndikimit të UPF tek konsumatorët ishte edhe ai i ngarkesave tarifore. Nivele të larta të UPF kanë çuar në tarifa të panevojshme të larta, prandaj në të vërtetë, është dashur të reflektojnë një ndërsubvencionim me ujin e faturuar, në të kundërtën ofruesit e shërbimeve do të kishin mbetur financiarisht të paqëndrueshme dhe duke mos qenë në gjendje të sigurojnë shërbimin e duhur për konsumatorët e tyre.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Gjatë monitorimit, analizës së gjendjes, shkaqeve dhe trendëve të menaxhimit të humbjeve të ujit nga KRU, mund të vijmë në përfundim se:

- Humbjet e ujit janë në nivel të lartë prej 55%, pa ndonjë përmirësim esencial gjatë kësaj periudhe. Lëvizjet në normat e UPF, me një interval të ngushtë $\pm 3\%$, në këtë periudhe vlerësuese me tepër besohet se është për shkakun e lëvizjeve në prodhimin e ujit se sa ato të jenë ulje efektive të UPF. Aktualisht kjo është një nga sfidat më të mëdha me ndikim në eficienten operative-financiare si dhe nivelin e shërbimeve të ofruara nga KRU. Ndërsa vendi po kalon nëpër krizën e resurseve ujore për shkakun e thatësirave të njëpasnjëshme, ky joefikasitetë duhet sa më parë të vihet në një kontrollë të arsyeshëm,
- Zvogëlimi i UPF aktualisht është prioriteti më i lartë për sektorin e ujit në Kosovë. Kompanitë kanë hartuar një qasje strategjike të menaxhimit të UPF, ato (7- KRU), kanë hartuar planet strategjike për zvogëlimin e UPF për një periudhë pesëvjeçare (2018-2022) dhe objektiva e reduktimit të UPF, në parim është marrë si qëndrim të jetë një norme prej 2% në baza vjetore, filluar nga niveli i gjendjes aktuale nga secila për të arritur në një përmirësim prej 10%, me përfundimin e strategjive. Strategjia Zhvillimore e Kosovës (2016-2021), e ka definuar si prioritet strategjik, përderisa ARRU ka përcaktuar një nivel të UPF nën 25%, si të pranueshëm,
- E dhëna për ujin e prodhuar në shumicën e KRU, nuk është i saktë dhe i besueshëm, meqenëse këto kompani ende një sasi të konsiderueshme të ujit e vlerësojnë në mungesë të ujëmatëseve apo edhe ujëmatëseve jo funksional (pasaktësi në matje). Jo të gjithë konsumatorët janë me matje dhe kur faturat e tyre nuk bazohen në matje dhe si të tillë ata nuk ka asnjë nxitje për të ruajtur ujin. Faturat e ngarkuara me paushall zakonisht përfaqësojnë një vëllim ekuivalent më të ulët sesa që është përdorur në të vërtetë. Prandaj matja e saktë e prodhimit dhe konsumit të ujit është thelbësore për t'i mundësuar ARRU-së të rregullojë në mënyrë efektive KRU në mënyrë që këto të fundit të menaxhojnë UPF për të arritur objektivat e përcaktuara,
- Kompanitë kanë filluar të raportojnë UPF sipas MBU në ARRU, me të cilin në fakt është standardizuar metodologjia e vlerësimit, komponentët e UPF si dhe terminologjia sipas praktikave më të mira ndërkombëtare MBU-sipas ANU. Modulet e bilanceve të ujit të për vitin 2018, dhe 2019H1 (gjashtë mujori i parë -2019), janë azhurnuar nga KRU, dhe janë raportuar ne ARRU, si të tilla ato paraqesin një hap thelbësor në drejtim të vlerësimit dhe identifikimit të UPF, megjithëse saktësia dhe besueshmëria e tyre lënë shumë për të dëshiruar.

Bazuar nga analizat e dala nga Modelet e Balancave të Ujit dhe trendëve të UPF, përgjatë viteve dhe më qëllim të menaxhimit dhe reduktimit të UPF, sugjerojmë KRU, ARRU, dhe Qeverinë e Kosovës, të ndërmarrin hapat si në vijim:

- Menaxheret e kompanive duhet të aktivizohen me intensivitet më të lartë dhe të vënë në dispozicion të gjitha resurset e kompanisë si ekipin e kontrollit të humbjeve, stafin operacional dhe menaxherial, lexuesit si dhe administratën mbështetëse në funksion të zvogëlimit të UPF,
- Zbatimi dhe implementimi i strategjive dhe veprimeve për zvogëlimin humbjeve të ujit dhe kontrollimit të UPF sipas MBU dhe të bëhet vlerësimi i progresit hap pas hapi dhe treguesve të matshëm,

- Në të gjitha sistemet trajtuese të instalojë ujëmatës të matjes së ujit të trajtuar, të siguroj që të gjithë konsumatorët të faturohen sipas ujëmatësve ato duhet të mirëmbahen-verifikohen, zëvendësohen sipas një programi zbatues nga KRU,
- Ofruesit e shërbimeve të ujit gjithashtu do të duhet të praktikojnë një modelim të përshtatshëm të shtrirjeve të sistemit (në pjesët ekzistuese dhe pjesë të reja të rrjetit të themelojnë sistemin e menagjimit të ujit sipas DMA-ve) dhe të përdorin punime, materiale dhe pajisje me cilësi më të lartë,
- ARRU dhe politikë-bërësit duhet të kërkojnë nga ndërmarrjet e ujit që të bëjnë kontrole vjetore të ujit dhe të botojnë rregullisht të dhëna të hollësishme të UPF, të cilat pastaj mund të auditohen në mënyrë të pavarur nga ARRU, në bazë të kriterëve dhe kategorizimeve të detajuara që reflektojnë saktësi dhe besueshmëri të lartë,
- Sigurimi i stimujve për menaxhmentin dhe stafin e ujësjellësit për të arritur dhe mirëmbajtur zvogëlimin e UPF. Kjo duhet të jetë proporcionale me benefitet nga rritja e efikasitetit në zvogëlimin e UPF.
- Në përputhje me rekomandimet e Qeverisë së Kosovës (KNMU) të aplikojnë "kontrata të performancës ndërmjet NJPM-NP dhe BD për KRU, bazuar në indikatorët e performancës dhe planeve të biznesit të aprovuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.
- Po ashtu edhe Bordet e Drejtorëve të obligohen dhe angazhohen për zvogëlimin e ujit të pa-faturuar dhe treguesve të tjerë duke implementuar kontratat e përhershme të bazuara mbi performancën e menaxhmentit të KRU.

Shënim: Të dhënat e përdoruar në analizë për nevojat e këtij Raporti janë marrë nga:

- ✓ Raportet vjetore të performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë (2013-2018)
- ✓ Modulet e Balanceve të Ujit nga KRU-2018, të Raportuara nga KRU- versionet finale të dërguara në ARRU si dhe
- ✓ Të dhënat e raportuara nga KRU -2019, të cilat janë ende të pa audituara (verifikuara) nga ARRU

SHTOJCA: Balanci i ujit për KRU-të për periudhën 2018

Figura 1 – Balanci i ujit për KRU “Prishtina” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 54,569,918 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 3.4%	Konsumi i Autorizuar 22,238,007 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.1%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 21,841,205 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 21,131,711 m3/year	Uji i Faturuar 21,841,205 m3/vit
			Konsumi i Pa-matur i Faturuar 709,494 m3/year	
		Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 396,802 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.3%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 108,570 m3/year	Uji i Pa-faturuar 32,728,713 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 5.7%
		Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 288,232 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 4.5%		
	Humbjet e Ujit 32,331,911 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 5.8%	Humbjet Komerciale 17,643,671 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 4.7%	Konsumi i Pa-autorizuar 11,658,100 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 7.1%	
			Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 5,985,571 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 1.8%	
	Humbjet Fizike 14,688,240 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 13.9%			

Figura 3 – Balanci i ujit për KRU “Hidroregjioni Jugor” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 17,038,292 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 7.7%	Konsumi i Autorizuar 7,546,409 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.1%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 7,347,813 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 6,750,790 m3/year	Uji i Faturuar 7,347,813 m3/vit
			Konsumi i Pa-matur i Faturuar 597,023 m3/year	
		Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 198,596 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.8%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 35,596 m3/year	Uji i Pa-faturuar 9,690,479 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 13.5%
		Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 163,000 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 4.6%		
	Humbjet e Ujit 9,491.883 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 13.8%	Humbjet Komerciale 6,351,509 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.8%	Konsumi i Pa-autorizuar 5,049,045 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.5%	
			Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 1,302,464 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.0%	
	Humbjet Fizike 3,140,374 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 42.0%			

Figura 4 – Balanci i ujit për KRU “Hidrodrini” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 25,366,310 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 10.0%	Konsumi i Autorizuar 10,105,451 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 9,662,715 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 8,844,709 m3/year	Uji i Faturuar 9,662,715 m3/vit
		Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 442,736 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.2%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 422,736 m3/year	Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 20,000 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 4.0%
			Humbjet Komerçiale 11,844,213 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.9%	
	Humbjet e Ujit 15,260,859 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 16.6%	Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 2,224,638 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.0%	Humbjet Fizike 3,416,646 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 75.5%	Uji i Pa-faturuar 15,703,595 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 16.2%

Figura 5 – Balanci i ujit për KRU “Mitrovica” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 28,347,492 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar 11,715,719 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.1%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 11,553,469 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 9,458,171 m3/year	Uji i Faturuar 11,553,469 m3/vit
		Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 162,250 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.7%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 102,250 m3/year	Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 60,000 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 10.0%
			Humbjet Komerçiale 10,085,840 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.9%	
	Humbjet e Ujit 16,631,773 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 2,296,740 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.9%	Humbjet Fizike 6,545,933 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 4.5%	Uji i Pa-faturuar 16,794,023 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%

Figura 6 – Balanci i ujit për KRU “Gjakova” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 14,992,458 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar 9,013,084 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 8,467,413 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 8,112,059 m3/year	Uji i Faturuar 8,467,413 m3/vit		
			Konsumi i Pa-matur i Faturuar 355,354 m3/year			
			Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 545,671 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 545,671 m3/year	Uji i Pa-faturuar 6,525,045 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	
				Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 0 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%		
	Humbjet e Ujit 5,979,374 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Humbjet Komerciale 4,668,005 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.5%	Konsumi i Pa-autorizuar 3,139,000 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.6%	Konsumi i Pa-autorizuar 3,139,000 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.6%		
			Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 1,529,005 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 1.9%			
Humbjet Fizike 1,311,369 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 8.9%						

Figura 7 – Balanci i ujit për KRU “Bifurkacioni” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 8,982,619 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 18.8%	Konsumi i Autorizuar 3,424,683 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 3,350,038 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 3,208,173 m3/year	Uji i Faturuar 3,350,038 m3/vit		
			Konsumi i Pa-matur i Faturuar 141,865 m3/year			
			Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 74,645 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.4%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 2,450 m3/year	Uji i Pa-faturuar 5,632,582 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 30.0%	
				Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 72,195 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.4%		
	Humbjet e Ujit 5,557,937 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 30.4%	Humbjet Komerciale 4,246,591 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.7%	Konsumi i Pa-autorizuar 3,163,546 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.5%	Konsumi i Pa-autorizuar 3,163,546 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 3.5%		
			Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 1,083,045 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.0%			
Humbjet Fizike 1,311,345 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 129.1%						

Figura 8 – Balanci i ujit për KRU “Hidromorava” 2018

Vëllimi Hyrës në Sistem 8,464,519 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar 4,027,308 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Konsumi i Autorizuar i Faturuar 4,012,702 m3/vit	Konsumi i Matur i Faturuar 3,525,645 m3/year	Uji i Faturuar 4,012,702 m3/vit
			Konsumi i Pa-matur i Faturuar 487,057 m3/year	
	Konsumi i Autorizuar i Pa-faturuar 14,606 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 0.2%	Konsumi i Matur i Pa-faturuar 13,356 m3/year	Konsumi i Pa-matur i Pa-faturuar 1,250 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.0%	Uji i Pa-faturuar 4,451,817 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%
	Humbjet e Ujit 4.437.211 m3/vit Margjina e Gabimit [+/-] 0.0%	Humbjet Komerciale 2,930,869 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.5%	Pasaktësitë e Ujëmatësve të Konsumatorëve dhe Gabimi në Traitimin 885,701 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 2.0%	
		Humbjet Fizike 1,506,343 m3/year Margjina e Gabimit [+/-] 4.8%		